



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 60/2019  
Datë: 28 janar 2019

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur me datë 28 janar 2019, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Për rishpalljen e konkursit të brendshëm për plotësim me tri (3) pozita për prokurorë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- II. Shpallja duhet të përmbajë informatat e përcaktuara në Rregulloren Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim dhe Shpalljen për avancim ta publikojë në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

**Bahri Hyseni**  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit;
- Arkivit të KPK-së.